



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

**NJOFTIM PARAPRAK PËRQËNDRIMI**

Rasti: Përfitim kontrolli te HARRIS Corporation / në shoqërinë Global Connectivity Services.

Në datën 6 dhjetor 2010, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të kontratës së shitjes së aksioneve dhe aktivitetit të nënshkruar nga palët pjesëmarrëse (HARRIS Corporation dhe Schumerg B.V), më datë 6 Nëntor 2010 në USA me objekt përfitim e kontrollit në shoqërinë Global Connectivity Services, me anë të blerjes së entiteteve dhe aktiviteteteve të shoqërisë Global Connectivity Services nga HARRIS Corporation.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Për HARRIS Corporation: është shoqëria mëmë që së bashku me filialet e saj ushtron veprimtari ndërkombëtare në fushën e komunikimit dhe teknologjisë së informacionit, e cila i shërben klientëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë në më shumë se 150 vende. Veprimtaria kryesore e HARRIS Corporation është zhvillimi i kategorisë më të mirë të produkteve, sistemeve dhe shërbimeve për klientë globalë (assured communications®) duke përfshirë komunikimet RF, komunikimet qeveritare, komunikimet e transmetimit;
- Për Global Connectivity Services: është pjesë e Schlumberger Information Solutions. Ajo ofron shërbime fundore të ndërlidhjes për vendndodhje të largëta. Shoqëria gjithashtu është një prej shoqërive të cilat prodhojnë sisteme të stabilizuara antenash.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)**